

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Sot me datë _1_/_11_/ 2018, une i quajtuari Xhabir Kajtazi me Nr. Pasaportë P00992550, shtetas kosovar i datëlindjes 06.10.1951, banues në adresën International village, Rruga Tokyo Nr. 116, Hajvali, Prishtine, Kosovë, kam vendosur të nënshkuaj Aktin e Themelimit të mëposhtëm të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria", aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statusi i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, së cilës i bashkangjitet (më poshtë "Shtojca 1).

Neni 1- Emertimi

Emërtimi i Shoqërisë është "UNION BRANDS SH.P.K"

Neni 2- Selia

Selia e Shoqërisë është në adresën Rr. Lidhja e Prizrenit, Pallati Nr. 4/475 Kati 1, Zona kadastrale 8270, Tiranë.

Neni 3- Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë e pacaktuar.

Neni 4- Objekti i Shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "UNION BRANDS sh.p.k" do të zhvillojë aktivitetet me objektin e mëposhtëm:

Të blejë apo të zotërojë nëndonjë mënyrë tjetër, të importojë, magazinojë, ruajë, eksportojë apo tregtojë me shumicë dhe pakicë mallra të ndryshme, përfshirë ato ushqimore, bujqësore e blegtorale, industriale, si dhe të çdo lloj malli tjetër.

Shoqëria ka gjithashtu të drejtë të ketë pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare si dhe të ndërmarrë çdo akt financiar, ekonomik apo tregtar të lidhur me objektin kryesor të saj dhe /ose që gjykohet i nevojshëm apo i leverdishëm për të.

Të paketojë mallra dhe lëndë të importuara.

Të shërbejë si përfaqësues shitje dhe marketingu, agjent shitjeje për firma vendase dhe të huaja etj.

Të angazhohet në shitje me shumicë dhe pakicë dhe të hapë dyqane, degë dhe/ose zyra po të jetë e nevojshme për arritjen e qëllimeve të shoqërisë etj.

Qiradhënie mjetesh e automjetesh të llojeve të ndryshme.

Neni 5 – Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1,000 (një mijë) leke.

5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, e cila është e nënshkuara dhe për t'u shlyer, me vlerë nominale 1,000 (një mijë) Lek dhe e zotëruar si më poshtë:

- Z. Xhabir Kajtazi 1.00 kuotë

Neni 6 – Kontributet

6.1 Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është ofruar si më poshtë :

Z. Xhabir Kajtazi, qytetar kosovar kontribut në para të barabartë me 1,000 Lek

Neni 7 – Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 – Administrimi

Administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme caktohet:

Z. Xhabir Kajtazi me Nr. Pasaportë P00992550, shtetas kosovar i datëlindjes 06.10.1951.


Neni 9 – Te tjera

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje së bashku me Shtojcën 1 Statuti.

ORTAKU THEMELUES



Emer mbiemer



(nënshkrimi)